




Nga cikli i ulët në atë të lartë

Informacione për prindërit

Mbas klasës së 6-të të ciklit të ulët fëmijëve u qëndrojnë të hapura rrugë të ndryshme në ecurinë e tyre shkollore. Ata frekuentojnë më tej ose shkollën fillore ose ata kalojnë në gjimnaz dhe lënë kështu shkollën fillore.



Cikli i lartë i shkollës fillore

Mbas klasës së 6-të, cikli i lartë i shkollës fillore klasifikohet në degë me kërkesa të larta të ndryshme. Lokalitetet shkollore mund të udhëheqin dy ose tre degë pra: degët A dhe B ose degët A, B dhe C. Dega A është një ndër degët më me kërkesa të larta në aspektin e njohurive.

Vendimin se cilën degë do ta frekuentojë fëmija e marrin së bashku mësuesët dhe prindërit. Në rastin e një papajtueshmërie për ciklin e lartë vendos këshilli adekuat ndërmjetësues i shkollës.

Vendimi merret sipas një vlerësimi të përgjithshëm. Kjo përmban sukseset shkollore të një fëmije, sjelljen e tij në punë dhe mësim, sjelljen e tij sociale si dhe gjendjen e zhvillimit të tij.

Për të evidentuar kapacitetin e ndryshëm mësimor të fëmijëve në secilën lëndë, lokalitetet shkollore mund të vendosin nivele kërkesash në lëndët matematikë, gjermanisht, frëngjisht dhe anglisht.

Nivelet e kërkesave janë niveli I, II dhe III- nga ku niveli III është me më shumë kërkesa. Ndarja në nivele kërkesash bëhet në bazë të rezultateve të përgjithshme të një fëmijës në lëndën përkatëse.

Në varësi të suksesit mësimor dhe nivelit të zhvillimit të fëmijës mundësohen dy herë në vit (në klasën e 1-rë të ciklit të dytë tre herë në vit) ndërrime të degëve dhe shkallëve/niveleve të kërkesave. Por vendimi përfundimtar përsëri duhet të merret ndërmjet mësuesve dhe prindërve dhe në rast mospajtimesh vendos atëherë këshilli ndërmjetësues shkollorë.

Hyrja në shkollimet profesionale me pretendime mbas kohës së detyrueshme shkollore apo kalimit prej ciklit të dytë të shkollës fillore në një shkollë të mesme i papaprin frekuentimi i degëve dhe niveleve me kërkesa të larta.

Rrjedha e mundshme kohore e procedurës së kalimit

Hapi	Momenti	Veprimtaria
1	Në tremujorin e parë të klasës së 6-të të ciklit të ulët	Shkolla i informon prindërit për organizimin e ciklit të lartë dhe secilin drejtim shkollor. Ajo u vë theksin mbrëmjeve informative të gjimnazeve.
2	Deri në fund të janarit	Mësuesi i klasës bën një bisedë me prindërit mbi gjendjen dhe ecurinë e ardhëshme të fëmijës.
3	Deri në mesin e marsit	Prindërit marrin rekomandimin e kalimit / ndarjes nga mësuesi dhe zhvillojnë mbi këtë një bisedë me mësuesin e klasës në praninë e fëmijës përkatës. Nëse janë të gjithë të një mendimi, atëherë merret parasysh klasifikimi / caktimi në ciklin e lartë. Ajo kumtohet zyrtarisht nëpërmjet letërkëmbimit.
4	Mars / prill	Në rast mosmarrëveshjeje zhvillohet një bisedë e dytë prindërore me mësuesin e klasës ku marrin pjesë gjithashtu edhe një antar i drejtorisë së shkollës dhe një mësues i ciklit të lartë. Në rast marrëveshjeje merret parasysh klasifikimi /caktimi në ciklin e lartë. Ajo kumtohet zyrtarisht nëpërmjet letërkëmbimit. Tek një mosmarrëveshje dosjet i dërgohen më tej te këshillit ndërmjetësues të shkollës së ciklit të lartë për një vendim përfundimtar, dhe më pas rezulton...
5	...deri në maj / qershor	...vendimi i këshillit ndërmjetësues dhe caktimi definitiv.

Gjimnazi (shkolla e mesme)

Nxënëset dhe nxënësit me rezultate shumë të mira, mundet të frekuentojnë mbas klasës së 6-të gjimnazin ose një shkollë të mesme. Deri më 15 mars prindërit duhet që ta regjistrojnë fëmijën e tyre në një gjimnaz. Fëmija duhet të japë një provim pranues. Notat e përvojës në ciklin e ulët merren po ashtu parasysh. Si notë e përvojës tek fëmijët e klasës së 6-të të shkollës fillore vlen mesatarja e notave në gjermanisht dhe matematikë

Në provimin pranues kërkohen ata njohuri dhe aftësi, të cilët nxënëset dhe nxënësit e aftë kanë marrë gjatë frekuentimit të gjashtë klasave fillore të Cyrihut deri tek data për provim.

Ku gjenden informacionet e hollësishme?

Mbi kalimin në ciklin e lartë të shkollës fillore

Në faqen e internetit të administratës së shkollës fillore mund të gjeni informatat përkatëse si vijon:

www.volksschulamt.zh.ch

Eltern → Die Zürcher Volksschule

Shumë më të rëndësishme për prindërit janë informacionet nga lokaliteti i „**juaj**“ shkollorë. Edhe lokalitetet shkollorë kanë prezantimet e tyre në faqet e internetit. Një vështrim i përgjithshëm gjendet në:

www.volksschulamt.zh.ch

→ Schulen im Kanton Zürich

→ Volksschulen

Personi më i besueshëm, të cilit ju mund ti drejtoheni është për çdo rast mësuesi i fëmijës tuaj.

Për kalimin në gjimnaz

Në faqen e internetit të drejtorisë arsimore të kantonit të Cyrihut, prindërit mund ti gjejnë të gjitha informacionet e duhura.

www.bildungsdirektion.zh.ch

→ Schulstufen → Mittelschulen.

Këtu ju mund të gjeni veçanërisht

udhëzime për regjistrimin dhe prezantime në internet të të gjitha gjimnazeve dhe shkollave të mesme të tjera në kanton.